



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.08/24
Prishtinë, më 24.4.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Pal Lekaj.

Të ftuar: Hekuran Murati, ministër i Financave, Punës dhe Transfereve; Vlora Spanca, auditore e përgjithshme, ZKA, Bezad Halilaj, zv.auditor i përgjithshëm, ZKA, Safet Berisha, ZKA, Ramadan Gashi, ZKA; Krenare Sogojeva-Dermaku, kryetare e Bordit, AIP, Lumnije Demi, AIP; Valon Kryeziu, Dafina Hasanmeti, Frashër Murtezaj, Yll Buleshkaj, kryetar i Bordit, APK; Alban Mehmeti, kryesues i Bordit, KPMSHC, Bujar Sadiku, Jeton Koca, Ardita Demi, Malësore Gashi, Eshref Shabani.

Munguan: Ferat Shala, Duda Balje.

Pjesëmarrës tjerë: Driada Thaçi, ZKA; Festim Bytyçi, GP AAK; Anduena Bajqinovci, RTV Dukagjini; Fjollë Haziri, KDI; Valmire Avdullahu, EO, Qëndresa Duraku, RTK; Shqipe Pajaziti, KosovaPress.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli, si dhe Diar Beqaj, praktikant në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rëndit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më datë 13.3.2024 dhe 20.3.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-299 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj;**

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport për Projektligjin 08/L-207 për tekste shkollore;
6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022 dhe 2023;
7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022 dhe 2023;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022 dhe 2023;
9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2022 dhe 2023;
10. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2025-2027;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që si pikë shtesë e rendit të ditës, të jetë edhe **Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes për Projektligjin së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për projektin “ Banim social adekuat”**. Pasi e hodhi në votim, konstatoi se me shumicë votash, Komisioni miratoi rendin e ditës, me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtur më datë 13.3.2024 dhe 20.3.2024

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, miratohen procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më datë 13.3.2024 dhe 20.3.2024.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-299 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj

Kryetari: Në bazë të nenit 83, paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit, projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare e shqyrton Komisioni përgjegjës-raportues.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar Projektligjin **nr. 08/L-299** për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që ta shqyrtojë projektligjin dhe të paraqesë raportin me rekomandime në Kuvend.

Ratifikimi i Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj, ka për qëllim ndërtimin e një impianti të ri për trajtimin e ujërave të zeza, rehabilitimi dhe zgjerimi e rrjetit të ujërave të zeza në Komunën e Ferizajt dhe në Komunën e Kaçanikut. Projekti do të përfshijë dy financues: Bankën

Evropiane për Investime dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim kap vlerën prej 20,000,000 euro. Projekti është i ndarë në dy pjesë: pjesa A, punët, mallrat dhe shërbimet për ndërtimin e impiantit të ri të trajtimit të ujërave të zeza dhe zgjerimin e sistemit të kanalizimit në rajonin e Ferizajt, duke i shërbyer një popullsie prej përafërsisht 90.000 banorësh, me një kapacitet mesatar të pritur deri në 17,500 m³/ditë; dhe pjesa B, shërbime konsulence për asistencën dhe mbikëqyrjen e Njësisë për Implementim të Projektit. Kohëzgjatja e kredisë është 15 vite, me 3 vite grejs periudhë. Norma e interesit është variable dhe tarifa e zotimit është 0,5 % për vit.

Lidhur me këtë pikë kemi ftuar ministrin e Financave, z. Hekuran Murati, nga i cili kërkojmë që të prezantojë dhe të arsyetojë projektligjin në fjalë.

Hekuran Murati, pasi falënderoi të pranishmit, tha se është kënaqësi që sot para jush mund të paraqesë pikën e radhës, që ka të bëjë me projektligjin për marrëveshjen e Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, si dhe BERZH-it, për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj. Projekti përfshin, pra siç e thashë, financimin e ndërtimit të një impianti për trajtimin e ujërave të zeza dhe financuesi kryesor në këtë rast është BERZH, por gjithashtu janë mbështetur edhe me grante nga korniza e Ballkanit Perëndimor për Investime. Marrëveshja e kredisë me BERZH-in ka vlerën prej 20,000,000.00 EURO, dhe siç e thashë, në kuadër të këtij projekti kemi dërguar tashmë aplikacionin për grant-investim në rundin e fundit të kornizës së investimeve të Ballkanit Perëndimor në vlerë prej 10 milionë euro, që do të mbulojë pjesën tjetër të shpenzimeve kapitale për projektin. Qëllimi i projektit është *financimi i ndërtimit të një impianti të ri për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj, zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve dhe financimi i asistencës teknike përkatëse, që do t'i ofrohet kompanisë*, përkatësisht të bifurkacionit. Projekti do të ofrojë shërbime të trajtimit të ujërave të zeza rreth 90,000 banorë në Komunën e Ferizajt dhe në Komunën e Kaçanikut, si dhe në zonat përreth dhe gjithashtu do të mundësojë shmangie nga dëmtimi i ekosistemeve lokale, duke parandaluar ndotjen e burimeve ujore lokale nga shkarkimet e ujërave të zeza të patrajtuara. Projekti pritet të përfundojë deri më 31.12.2027. Sa i përket marrëveshjes për kredi, pra janë kushtet standarde që ofrohen nga BERZH-i dhe qëllimi i projektit është financimi i ndërtimit të impiantit. Valuta është në euro, shuma është 20 milionë, siç edhe e thashë, ndërsa kohëzgjatja është 12 vite, ku tre prej tyre janë grejs periudhë, ku nuk parashihet kthim i kredisë, por vetëm pagesa e interesave, ndërkaq norma e interesit është 1% plus norma e euravorit gjashtëmujor, kurse tarifa e zotimit është 0.5 % vjetore, në shumën e patërhequr.

Për shkak se nuk ka kuorum, votimi shtyhet për një mbledhje tjetër.

4.Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes për Projektligjin së kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për projektin “Banim social adekuat”.

Kryetari: Shkojmë te pika pasuese e rendit të ditës, që është Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për projektin “**Banim social adekuat**”. Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Buxhet është ngarkuar në cilësitë e Komisionit funksional.

Hekuran Murati: Pika e radhës, siç edhe paralajmëruat, i nderuar kryetar, ka të bëjë me një marrëveshje të kredisë, e nënshkruar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës, për projektin e banimit social adekuat dhe kjo marrëveshje, pra është nënshkruar në janar të këtij viti, në mes të Republikës së Kosovës dhe BZHK-së, në zyrat e BZHKE-së, pra në Paris.

Objektivi kryesor i këtij projekti është zhvillimi i sistemit të menaxhimit të banimit social në Kosovë

dhe ngritja e numrit të njësive të banimit social në vend. Me këtë rast, marrëveshja përfshin disa komponentë kyçë për arritjen e qëllimit të projektit. Në kuadër të kësaj, përfshihet ngritja e numrit të njësive të banimit social, që mund të bëhet duke rinovuar banesat sociale ekzistuese, ndërrimin e ndërtesave ekzistuese në banesa të reja sociale, ndërtimin e banesave të reja të banimit social e të tjera. Nga kjo komponentë, mund të përfitojnë familje të cënueshme dhe ato me të ardhura të ulëta, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, po ashtu, përmes qirave të përballueshme mund të përfitojnë edhe familjet me të ardhura të ulëta, deri tek ato me të ardhura mesatare, të cilat e kanë të vështirë të përballojnë çmimet e tregut për banim. Nga marrëveshja mund të financohet edhe përmirësimi i shtëpive ekzistuese në pronësi të familjeve të qëndrueshme, të atyre me të ardhura të ulëta, në mënyrë që ato të bëhen të përshtatshme për jetesë, në raste të veçanta, edhe ndërtimin e shtëpive të reja për këto shtresa. Marrëveshja, varësisht nga nevojat e projektit, po ashtu lejon një pjesë të mjeteve të përdoren për të asistuar komunat dhe Ministrinë e Mjedisit të Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në zhvillimin e sistemit dhe implementimin e nënprojekteve. Marrëveshja në fjalë ka vlerën totale prej 25 milionë euro dhe do t'i mundësojë Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të zhvillojë sistemin e banimit social në vend, të rrisë numrin e njësive të banimit social në raport me numrin e njësive totale të banimit, si dhe të përmirësojë kushtet e jetesës për familjet me të ardhura të ulëta. Kushtet e marrëveshjes, pra janë si vijon: shuma është 25 milionë euro, kohëzgjatja është 20 maturitet, ku 5 prej tyre janë grejs periudhë; norma e interesit përcaktohet me rastin e disbursimit, por vlen të theksohet që janë kushte koncesionare, meqenëse bëhet po një projekt, bëhet fjalë për një projekt social dhe zhvillimor, nuk ka tarifë të shërbimit dhe nuk ka tarifë të zotimit. Pra, të kuptoheshin pak a shumë kushtet, rrezik valutor nuk ka meqenëse është në valutën euro, ndërkaq rreziku i normës së interesit vlen e njëjta gjë, sikurse për BERZH-in.

Visar Korenica, bëri dy pyetje sa i përket projektligjit dhe kësaj marrëveshje për banim: Sa njësi të banimit do të ndërtohen dhe sa është kohëzgjatja e implementimit të projektit?

Hekuran Murati: Nuk di nëse e kam shifrën për njësitë e banimit, por siç e thashë, kjo është më tepër një proces dinamik, që do të bëhet në bashkëpunim me komunat.

Pra, zbatuesi i projektit është Ministria e Infrastrukturës, dhe në bashkëpunim me komunat, kanë filluar të identifikohen parcelat, ku do të ketë ndërtime dhe pastaj mbetet të shihet sipas dinamikës, nëse ka nevojë të ketë ndërtim nga zero, pra ndërtesa të reja apo edhe mund të ketë ripërshtatje të ndërtesave ekzistuese, sepse që të dyja këto janë mundësi në kuadër të projektit. Por, sa i përket shifrës së saktë, po besoj që mbizotërojnë edhe kushtet e tregut sa i përket kostos së ndërtimit, të cilat mund të ofrohen dhe përpjesëtimi me vlerën e kredisë. Projekti, si tërësi, pra parashihet kur 25 milionë euro, pra siç e thashë, janë nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës, 11 milionë euro parashihen si kontribut financiar i vet shtetit, ndërkaq 7 milionë euro tjera parashihen si kontribut në natyrë. Pra, në këtë rast, komuna duke ofruar tokat për ndërtim dhe 2 milionë euro tjera grant për asistencë teknike, që përfitohet në kuadër të këtij projekti. Në tërësi, shifra është 45 milionë euro, kohëzgjatja është deri më 31.12.2031.

Avdullah Hoti: Pika që po diskutojmë është bukur kontradiktore, se t'u thuash njerëzve që kam për të ofruar banimin social, të shkon mandati edhe në fund të mandatit e mbërrin një marrëveshje edhe iu thua që në vitet e ardhshme, unë kam do t'iu mundësojë për të ndërtuar banim të përballueshëm me kushtin që komunat kanë për të kontribuar me 7 milionë. Besoj që kjo nuk është korrektësi para qytetarëve, se e keni pasur premtimin kryesor, pra ofrimin e banimit social për arsimtarë, për familje në asistencë sociale dhe për njerëzit që kanë nevojë. Ja ku është marrëveshja, duhet komunat të kontribuojnë me 7 milionë, kemi për t'iu ofruar këtë apo atë të padefinuar, asgjë se nuk e ke idenë se si do të zbatohet në praktikë, si kanë për t'u përzgjedhur rastet, çfarë shtëpish do të ndërtohen, kush ka për të përfutur prej tyre, mënyra sesi kanë për ta implementuar ato, kemi me hapë tenderë publikë apo kemi për ta bërë përmes skemave të bankave e tjera e tjera, nuk e ke idenë.

Pra, unë mendoj që është joserioze dhe duhet pranuar publikisht.

Pal Lekaj: Sa i përket kësaj marrëveshjeje, duhet ta kemi të qartë dhe të informohemi me disa sugjerime apo atë që e thatë. Për shembull, ju thatë që komunat mund të paguajnë 7 milionë. A keni marrëveshje paraprake me ndonjë komunë? Ju thatë që komunat duhet që të ofrojnë prona, a keni marrëveshje dhe a keni kërkuar? Gjakova, për shembull, i ka dy ndërtesa për banim social, që i ka përfituar nga Ministria e Mirëqenies Sociale përpara, por ka pasur shumë vështirësi, sepse paraprakisht është dashur një marrëveshje për mirëmbajtje dhe ku kalojnë pronësitë, dhe tani të vihet një marrëveshje e tillë, pa pasur marrëveshje paraprake me komunat, pa e ditur se sa është kërkesa për sa ndërtesa, për sa banorë? Por mendoj që duhet të kemi një informacion të saktë në këtë drejtim.

Eman Rrahmani: Ka qenë një studimi i fizibilitetit prej anës së Ministrisë së Ambientit dhe Infrastrukturës dhe besoj që ishte dashur me qenë goxha të detajuara, mirëpo ndoshta është dashur me qenë këtu edhe ministri, për të raportuar mënyrën qysh dhe çka mendon, meqë duhet të miratohet kjo kredi prej këtij komisioni, përndryshe e di që janë publikuar rezultatet e atij studimit të fizibilitetit për këtë çështje. Unë, personalisht, mendoj që ka mundur të jetë pak kredi për t'u rregulluar këtu në bashkëpunim me komunat dhe në bashkëpunim me ndërtuesit, investitorët të merren me ndërtime dhe kështu kemi pasur edhe diskutime të mëhershme edhe si VV, ku përmes koeficientit të ndërtimit, në secilin bllok, të lihen një ose dy katet e asaj ndërtese, për këto nevoja që besoj që nuk do të kishte kosto, por edhe nuk do të kishte pasur ndërtesa të tilla, ku grumbullohen kategori të njëjta dhe kishin qenë të shpërndara edhe në aspektin shoqëror në familje, që kishte qenë një situatë shumë më e mirë sesa kjo që mund të krijohet përmes saj, mirëpo sido që të jetë, unë mendoj që është një hap i mirë për t'ju mundësuar atyre, të cilët nuk kanë mundësi për ta zgjidhur çështjen e banimit, por besoj që ka pasur edhe kemi diskutuar dhe kemi premtuar edhe praktika më të mira sesa kredi që janë për këtë fushë.

Hekuran Murati: Po shkoj me radhë, atëherë nga temat që shtruat. Pyetja e parë ishte pse ka qenë e nevojshme që të merret kredi, sepse u tha edhe nga disa deputetë tjerë parafolës, në rastet kur ndoshta ka mundur të bëhet edhe me mjetet buxhetore. Sa i përket buxhetit, tani buxheti si tërësi është i fundmë, domethënë ka një tavan vjetor, me të cilin ne duhet të menaxhojmë dhe duhet t'i alokojmë ato mjete dhe për neve është tepër e rëndësishme dhe e nevojshme që të bëjmë edhe prioritetizime brenda përbrenda buxhetit, por dhe të shohim se cila është mënyra më e mirë, pra për të siguruar fonde me financim më të lirë apo koncesionar nga financimet e jashtme ta zëmë, nëse kemi 100 milionë euro brenda një viti si buxhet, të cilin e kemi të lirë për ta alokuar dhe e kemi opsionin që të alokojmë të zëmë në banim social apo në blerje të pajisjeve për ushtri. Domethënë, nëse jemi para kësaj alternative, tash edhe mund të themi që mund ta çojmë për banim social, sepse është nevojë më imediate dhe pastaj për ushtri të marrim hua. Mirëpo, huamarrja për ushtri, fillimisht nuk është se ka shumë institucione financiare që i japin hua dhe e dyta, nuk mund të ketë kushte koncesionare.

Pra, edhe nëse del dikush e të jep hua, normat e interesit janë 5-6% sipas kushteve të tregut. Tash edhe në këtë rast, nuk dua të gaboj që të përmend komuna specifike, meqenëse është një komunikim dhe diskutim që bëhet në mes të ministrit apo Ministrisë së Infrastrukturës, në këtë rast dhe komunave përkatëse. E di që ka pasur komunikime dhe ndoshta edhe mund t'i ndajmë këto informata gjatë seancës, por dhe kur edhe trajtohet, mund ta ftojme ministrin, pra që të sigurohemi që është atë ditë aty në seancë dhe të përgjigjet në këto pyetje.

Për shkak se nuk ka kuorum, votimi shtyhet për një mbledhje tjetër.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport për Projektligjin 08/L-207 për tekste shkollore

Kryetari: Shkojmë te pika e radhës së rendit të ditës, shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Arsim, Shkencë Teknologji, në lidhje me Projektligjin 08/L-207 për tekste shkollore.

Projektligji në fjalë është shqyrtuar nga Komisioni funksional për Arsim dhe Komisioni në fjalë e ka dërguar raportin me amendamentet të Komisioni për Buxhet. Komisioni për Buxhet është ngarkuar që të ofrojë një rekomandim në lidhje me implikimet financiare të projektligjit dhe amendamenteve. Në bazë të deklaratës së Departamentit të Buxhetit të Ministrinë e Financave, vlerësohet se Projektligji 08/L-207 përmban implikime buxhetore shtesë për buxhetin e Kosovës, në shumë prej 25,370,598.00 euro, për periudhën dyvjeçare 2023 dhe 2024. Vlerësimi është bërë nga Ministria e Financave, më datën 21.11.2022, mjete këto që nuk janë nuk kanë qenë të planifikuara në vitin paraprak. Ky projektligj do të krijojë implikime shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës, por, gjithsesi, të përballeshme amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për projektligjin në fjalë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Për shkak se nuk ka kuorum, votimi shtyhet për një mbledhje tjetër.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2022 dhe 2023

Vlora Spanca: I nderuar kryetar i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, të nderuar deputetë, të nderuar të pranishëm!

Faleminderit për ftesën, për të prezantuar raportet vjetore financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për dy periudhat 2022-2023. Buxheti i përfundimtar për Zyrën Kombëtare të Auditimit, i miratuar me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022, ishte 3,046,355 euro, ndërsa për 2023 ishte 3,051,646 euro, sikurse në vitet paraprake. Dhe në buxhetin për vitin 2022 dhe 2023, pjesëmarrja më e madhe ishte në paga dhe mëditje. Në fakt, shtesa rreth 66% e buxhetit total, mallra dhe shërbime rreth 22%, kategoritë tjera si shpenzimet komunale dhe investimet kapitale, gjithashtu ishin 2% në vitin 2023. Më lejoni të theksoj se opinionimi i auditimit për pasqyra vjetore financiare në vitin 2022 ishte opinionimi i pamodifikuar, që do të thotë opinionimi i pastër, ndërsa disa çështje që auditimi i ka identifikuar, janë adresuar me kohë dhe rekomandimet janë zbatuar plotësisht. Sa i përket vitit 2023, derisa po raportojmë, veçse e kemi marrë raportin e auditorit për pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe opinionimi i auditorit po ashtu është i pastër. Ajo çka është e rëndësishme, është se për herë të parë në Zyrën Kombëtare të Auditimit, auditori i jashtëm nuk ka evidentuar asnjë gjetje, përkundër aktiviteteve të shumta, të cilat i kemi pasur gjatë vitit 2023. Gjatë vitit 2022-2023, Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar të hyra jo-tatimore nga ofrimi i shërbimeve audituese, që rrjedhin nga marrëveshja me organizata ndërkombëtare, siç është Agjencia për Zhvillim, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe "Health Task Force Intercorporate Kosova". Këto janë të hyrat, të cilat ne kryejmë auditime për këto organizata dhe si kundërvlerë marrim një vlerë që i mbulon shpenzimet e auditimit. Totali i këtyre të hyrave për dy vite ishte në vitin 2022 9,660 euro, ndërsa për vitin 2023, 15,682 euro, të cilat i shkojnë buxhetit të Kosovës. Shpenzimet totale në paga dhe shtesa për vitin 2022, kanë qenë 2,154,086 euro, apo 94% e buxhetit të planifikuar. Me Ligjin për ndarjet buxhetore për 2022, numri i stafit të miratuar ishte 180, ndërsa në fund të vitit 2022, Zyra Kombëtare e Auditimit kishte 166 të punësuar. Struktura e numrit të përgjithshëm do të thotë është 83% personel auditues dhe pjesa tjetër është staf mbështetës. Shpenzimet në kategori janë më të ulëta sesa buxheti i aprovuar, për arsye se gjatë vitit 2022, në Zyrën Kombëtare të Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë larguar 8 punonjës, por po ashtu edhe shkuarja e stafit në pushime të lehonisë dhe pushime pa pagesë. Në anën tjetër, ne kemi punësuar 11 punonjës të rinj, shumica e tyre në pozita profesionale. Po ashtu, edhe në vitin 2023, ashtu siç e thashë, ka pasur nën-shpenzim dhe pjesën e pashpenzuar e kemi deklaruar te buxheti i shtetit. Numri i miratuar i personelit ishte 180 pozita. Përqindja e ulët e shpenzimit të pagat dhe mëditjet, po ashtu ka ardhur si rezultat, do të thotë i

11 punonjësve, të cilët janë dorëhequr nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe 4 të tjerë janë pensionuar, gjatë vitit 2023. Domethënë, ne e kemi punësuar 12 punonjës të rinj, shumica prej tyre auditorë të rinj. Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve, në fund të vitit 2022, ishin në vlerë prej 572,000 euro apo 84% e buxhetit final, përderisa për vitin 2023, buxheti për mallra dhe shërbime është shpenzuar 83%. Shpenzimet më të mëdha në këtë kategori vazhdon të marrë pjesë qiraja e objektit, ku pjesëmarrja e saj në totalin e shpenzimeve, si për vitin 2022, ashtu edhe për 2023, është rreth 28%, siç e paguajmë në vlerë vjetore prej 162,000,00 euro.

Unë e kam adresuar këtë çështje, qysh prej marrjes së mandatit tim, domethënë edhe te ju si komision, edhe te kryetari i Kuvendit, edhe te Ministria e Punëve të Brendshme, mirëpo ende nuk është bërë asnjë zgjidhje. Unë po e shfrytëzoj rastin t'ju ftoj, që të përkrahni Zyrën Kombëtare të Auditimit, në këtë drejtim, për shkak se nuk është kredibile, për një zyrë në institucion suprem të auditimit, të qëndrojë në objekt privat, duke i paguar një operatori ekonomik një vlerë prej 162,000 euro në vit, përderisa i njëjti mund të jetë edhe subjekt auditues. Pra, qoftë si individ apo qoftë edhe si subjekt afarist, ne kemi pasur, kam kërkuar edhe takime me ministren e Punëve të Brendshme, por që ato takime nuk janë realizuar, është dërguar një ftesë, në fakt një njoftim se mund të akomodohemi te ndërtesa, objekti ku ka qenë ish- RTV 21, tash në pronësi të AKP-së, ne e kemi pranuar atë propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me aq sa dimë, është shpallur edhe tenderi për dizajnin për Zyrën Kombëtare të Auditimit, mirëpo nuk e dimë se çka ka ndodhur aty. Kontrata aktuale me qiramarrësin është deri në janar të vitit 2025, për shkak se ka komentuar se mundet të bëhet një zgjidhje gjatë vitit 2024 dhe qëllimi ka qenë që për të dalë në objekt publik dhe për të mos paguar më qira. Nuk e kemi asnjë informatë deri më tash, se çka ka ndodhur me atë objekt, e kemi pa se është në renovim e sipër, por që nuk kemi marrë ndonjë informatë.

Pal Lekaj: Faleminderit për raportin, por po më intereson ta di, te kategoria që e keni cekur, ekonomike, paga dhe mëditje, aty keni cekur që nuk është realizuar krejt buxheti, për shkak se janë larguar 8 persona. Më intereson ta di pse janë larguar, cilat pozita janë larguar dhe cila ka qenë për shkak të pagës apo ka pasur diçka nën presion? Çka ka ndodhur që janë larguar 8 persona dhe nuk është shpenzuar buxheti komplet?

Vlora Spanca: Largimi i punonjësve nga ZKA, është shqetësim edhe për mua, edhe për secilin, është staf, në të cilin ne kemi investuar me vite. Pra, është një përvojë shumë specifike, e cila mund të merret vetëm përmes investimit, qoftë edhe përmes trajnimeve jashtë, po edhe përmes skemave të certifikimit tek të cilët kemi investuar. Çështja e largimit të stafit ka qenë 8 në vitin 2022, 11 në vitin 2023. Ne e kemi një formular, për të cilin kërkojmë që në rasti kur stafi largohet, arsyet e largimit dhe arsyeja e largimit është çështja e pagës, për shkak se tregu privat dhe bankat, organizatat e tjera ndërkombëtare, në momentin që aplikojnë një auditor me një përvojë dhe me një kualifikim të cilin ne ia kemi ofruar, është i pakonkurrueshëm me të tjerët. Pagat në tregun privat janë rritur, përderisa unë nuk e përmenda këtu në këtë takim dhe po e shfrytëzoj rastin të bisedoj edhe për çështjen e ligjit të pagave për sektorin publik, si auditore e përgjithshme e kam mirëpritur çështjen për ligjin e pagave për sektorin publik. Megjithatë, ne kemi dhënë komentet tona, qoftë në çështjen e rangimit të auditorëve, qoftë edhe në rëndësinë që e ka auditori i përgjithshëm, si institucion kushtetues, kemi pasur edhe takime me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me komisionin përkatës, megjithatë, jo të gjitha komentet janë marrë parasysh në ligjin për pagat e sektorit publik. Disa pozita nuk janë paraparë fare, për shembull pozita e drejtorit të Departamentit të Auditimit, nuk është paraparë fare në ligjin për pagat sektorit publik dhe më pastaj ekuivalentimi i është bërë me një koeficient të drejtorit të administratës, me 8,5, që përvoja e kualifikimi edhe rëndësia nuk janë ekuivalente me një drejtor të administratës dhe do të ketë aq shumë pakënaqësi, në anën tjetër, edhe vetë pozicioni i auditorit të përgjithshëm në ligjin e pagave, po e flasim jo si emër i përveçëm, por si njësi organizatë, institucion kushtetues, është ranguar në ligjin e pagave më poshtë. Po e them kështu një hierarki shumë poshtë, mos ta them shkurt e shqip, më poshtë se ministri dhe në pikëpamje të parë të

jap një mendim se është shndërruar në një auditor të brendshëm të ekzekutivit. Ne kemi bashkëbiseduar këtë çështje edhe në nivel të rajonit, në të gjithë rajonin, po flas vetëm rajonin si standard minimal, që ne ishte dashur t'i plotësojmë. Pra, asnjë nga institucionet supreme të auditimit në rajon nuk janë pjesë e rregullimit të përgjithshëm të pagave në nivel vendi, për shumë arsye: për shkak se e para, janë standardet ndërkombëtare për Institucionin Suprem të Auditimit, janë dy deklarata kryesore që janë magna-karta e auditorit, është deklarata e Limbës dhe Meksikës, e cila parësore e ka pavarësinë e institucionit, edhe në aspektin financiar. Tash, përveç aspektit financiar, me këto ndërhyrje në ligjin e pagave, i është bërë ndërhyrje edhe në aspektin funksional, edhe operativ, për shkak se Zyra Kombëtare e Auditimit nuk është diçka statike, ndryshon varësisht prej rrethanave dhe i përshtatet. Unë e kam të pamundur t'ua përshtat atyre veprimtarinë e zyrës në përputhje me rrethanat që janë në nivel global.

Kryetari: Unë e pajtohem që Zyra Kombëtare e Auditimit, krahas pavarësisë funksionale, duhet të ketë edhe pavarësinë e saj buxhetore dhe detyrimin për llogaridhënie, por s'kemi ç'të bëjmë, duhet të definohe mi në kuadër të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë, sidomos ato që mund të jenë subjekt auditimi nga ana juaj. E kuptoj shqetësimin tuaj, shpesh kemi shqetësime të ngjashme edhe nga institucionet tjera, mirëpo të paktën deri më tani, nuk kam qenë i vetëdijshëm për një tendencë të tillë dhe ç' është e vërteta nuk është që kam dëgjuar ndonjëherë, por gjithsesi e kuptoj rëndësinë.

Për shkak se nuk ka kuorum, votimi shtyhet për mbledhjen e radhës.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2022 dhe 2023

Kryetari: E nderuara zonja kryetare Sogojeva-Dermaku, mirë se keni ardhur dhe jeni përgjigjur në kërkesën e Komisionit për Buxhet, për ta shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitet 2022-2023. Në bazë të nenit 66 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, Agjencia për Informim dhe Privatësi, duhet t'i paraqesë Kuvendit raport vjetor, jo më vonë se 31 mars të çdo viti vijues.

Agjencia për Informim dhe Privatësi e ka dërguar raportin vjetor në Kuvend, brenda afatit ligjor dhe Komisioni për Buxhet është ngarkuar që t'i trajtojë këto raporte.

Krenare Sogojeva-Dermaku: Të nderuar, Agjencia për Informim dhe Privatësi, si institucionin i pavarur, ashtu siç e cekët edhe ju, domethënë në bazë të obligimeve ligjore që ka, ka paraqitur raportin. Unë paraqesë direkt pasqyrat financiare, pastaj edhe mund të flasim edhe për praktikën dhe obligimet që i kemi pasur në raport me zbatimin e dy ligjeve që ne i mbikëqyrim. Raporti i shpenzimeve për agjencinë, për vitin 2022, është ky: në fillim janë ndarë 421,580 euro, pastaj nga ky buxhet janë shpenzuar 259,000, që i bie 61% e buxhetit është shpenzuar. Kjo pasqyrë është pasqyra reale financiare e cila në fakt ka qenë për shkak të numrit të kualifikuar që kemi pasur të pozitave që ka qenë numri 34 i zyrtarëve, të cilët është dashur të rekrutohen, por në fakt nuk kemi arritur t'i rekrutojmë, për shkak të procedurave dhe kanë qenë diku në minus 16 pozita të pakryera, normalisht për shkak të këtij mos-rekrutimi të stafit, ka rënë edhe buxheti. Ndërsa, në mallra dhe shërbime janë shpenzuar 66% dhe për komunale, normal që shpenzimet komunale i kemi edhe më të vogla, diku 21%. Kjo është pasqyra e përgjithshme financiare.

Visar Korenica: Është folur pak rreth raportit të punës, respektivisht numrit të ankesave që kanë qytetarët për Agjencinë, qoftë për informim, sa i përket dokumentacioneve të ndryshme që i kërkojnë institucionet e ndryshme, që ju pamundësohet qasja në dokumente edhe për të dhëna personale.

Krenare Sogojeva-Dermaku: Patjetër, sa i përket vitit 2022, ankesat gjatë periudhës raportuese

kanë qenë 421 ankesa, nëse e krahasojmë me vitin paraprak për gjashtë muaj të vitit 2021, prej kur është funksionalizuar agjencia, kanë qenë 145, ndërsa ky numër domethënë është siç po e shohim edhe është trefishuar, por jo për gjithë periudhën, ta keni parasysh. Por, saktë, diku 331 ankesa janë mbyllur brenda vitit, ndërsa të tjerat kanë kaluar për vitin 2023, për shkak të procedurës që e kemi. Nëse e krahasojmë tani me vitin 2023, atëherë numri përsëri është rritur, është rreth 500-600. Domethënë, numri i ankesave është në rritje, që është në rritje tendenca e qytetarëve që po kërkojnë më shumë qasje, derisa në vitin 2021, ne kemi pasur më shumë ankesa nga OJQ-të dhe mediat, edhe në vitin 2022, në 2023 dhe në 2024.

Tani e shohim që qytetarët, individët, janë ata që bëjnë më shumë ankesa tek institucionet, çka do të thotë që kemi edhe një ndërgjegjësim të shoqërisë, që ta kërkojnë të drejtën e tyre për të qenë të informuar.

Gjithsesi, ankesat e parashtruara gjatë vitit 2022, kanë qenë 207 nga qytetarët, domethënë është një numër më i madh se tek OJQ-të dhe mediat, 130 nga OJQ-të dhe 76 nga mediat.

Institucionet ndaj të cilave janë parashtruar ankesat kanë qenë: 135 ndaj gjithë dikasterit qeveritar, 121 ndaj komunave dhe 165 ndaj institucioneve tjera, që përfshijnë: Zyrën e Kryeministrit, Kuvendin, prokuroritë, gjykatat, por edhe institucione tjera të pavarura. Në 74 raste, ne kemi nxjerrë vendime aprovuese, në 26 raste ne kemi nxjerrë vendime refuzuese dhe kemi pasur 4 gjoba të shqiptuara ndaj institucioneve publike. Çka është shumë me rëndësi nga ky numër, shihet që në shumicën e rasteve ne nuk kemi nxjerrë vendime detyruese, që do të thotë se ato janë mbyllur me vendime përmbyllëse. Së fundi, në mars është inauguruar Qendra për Siguri Kibernetike në Kosovë, qendra trajnuese dhe iu lejohet të bashkëpunoni me këto lloj agjencie që janë të specializuara në gjurmim të të dhënave që mund t'i atakojnë ose t'i nxjerrin lehtësisht përmes softuerëve të ndryshëm etj. dhe të krijohet bashkëpunim me ta, në mënyrë që të parandalohet një rrjedhje e informacioneve të ndryshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Nuk ka kuorum, kështu që votimi shtyhet për një mbledhje tjetër.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2022 dhe 2023

Kryetari: I nderuar z. Yll Buleshkaj, mirë se keni ardhur në kuadër të trajtimit të pikës së rendit të ditës, shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit 2022-2023. Në bazë të nenit 5, paragrafi 1.8 dhe nenit 15, paragrafi 1 i Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, agjencia i raporton Kuvendit një herë në vit.

Yll Buleshkaj: Në vitin 2022 e kemi pasur një buxhet, fillimisht në total prej 545,778 euro, i cili në fund të vitit, ka pasur -5000 euro, për shkak që i kemi kthyer disa mjete, si tërësi, në vitin 2022 buxheti është shpenzuar në shumën prej 99.1%. Është shpenzim real, pa marrë parasysh në numrin dhe 5,000 euro që janë larguar. Sa i përket kategorive, në paga dhe mëditje, i kemi pasur shpenzim 99.9%, te shpenzimi komunal kemi pasur 37% e pastaj të fundit 91% dhe për pasurinë jofinanciare, për projekte kapitale, kemi pasur një shpenzim prej 72.4%, te kapitalet është dukshëm që është shpenzim pak më i vogël, për shkak të parashikimeve dhe pastaj kontratat që kur janë realizuar, e ka pasur një kosto më të vogël.

Pastaj, në qoftë se kalojmë te viti tjetër, ne kemi kërkuar për shkak se në fund të vitit 2022, ka ndërruar edhe mandati. Ne kemi pasur kërkesa për ndryshim dhe për shtim të buxhetit, të cilat fillimisht, do të thotë vitin e kaluar, nuk janë realizuar ashtu siç kemi kërkuar, por nëse e krahasojmë vitin 2022 me 2023, kemi pasur një rritje vetëm prej 12 eurove.

Tutje, shpenzimet në kategorinë e pavarura kanë qenë 100%, sepse është dashur të shtohet buxheti, në mënyrë që të plotësohet deri në fund të vitit. Te komunat është në mënyrë të vazhdueshme shpenzim më i ulët, sepse një pjesë të mirë të shpenzimit të komunales ende vazhdon Ministria e Punëve të Brendshme që ta mbulojë rrjedhimisht. Por, ne duhet të planifikojmë, sepse është kërkesa

nga Ministria e Financave që t'i kemi fondet e planifikuara, ndërsa realizimi i tyre gjithmonë është më i ulët sesa që e planifikojmë. Zakonisht, gjatë rishikimit të buxhetit, ne gjithmonë e informojmë qeverinë, që janë rreth 5000 euro, të cilat në mënyrë historike nuk arrijmë t'i shpenzojmë, sepse këto shpenzime i mbulon Ministria e Punëve të Brendshme.

Do të thotë vitin e kaluar kemi pasur një realizim diku 95.11% të buxhetit si tërësi, prapë te projektet kapitale ka pasur një realizim më të dobët. Këtu, fillimisht, siç e përmenda më herët, ka qenë një projekt i vitit paraprak, sepse ne po flasim dhe nganjëherë po t'i kthehemi te numrat, absolut nuk janë që janë shumë, kanë qenë 10,000 euro, të cilat për shkak të vonesave dhe ardhjes së këtyre pajisjeve, në momentin e fundit, për të qenë të sigurt, Ministria e Financave i ka bart edhe 10,000 për gjetjen e njëjtë, në vitin e kaluar, përderisa 90% e atij projekti të realizuar në vitin 2022, e rrjedhimisht kemi pasur 10,000 euro, të cilat kanë qenë vetëm për të kursyer. E kemi ditur nga fillimi i vitit se nuk do t'i shpresojnë.

Ndërsa, te një projekt tjetër kapital, i cili ka qenë faqe elektronike e agjencisë, edhe pse kemi pasur një kosto reale mbi 6,000 euro, për ta realizuar si projekt në fund nga tenderët e realizuar, kjo ka qenë rreth 2,000 euro, do të kenë pasur një 4,000 që na kanë dalë më shumë. Rrjedhimisht, shumë shkurt, kjo është gjendja e buxhetit.

Nuk ka kuorum, ky votim shtyhet për votim në mbledhjen e radhës.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil për vitin 2022 dhe 2023

Kryetari: Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, atëherë të nderuar, mirë se keni ardhur dhe ju keni përgjigjur ftesës së Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere për të shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitet 2022-2023. Sipas nenit 4, paragrafi 2 i Ligjit për KPMSHC, për punën e tij, i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, së paku një herë në vit, dhe sa herë që i kërkohet, i ka dërguar raportet vjetore për vitin 2022-2023 në Kuvend dhe Komisioni është ngarkuar që ta shqyrtojë raportin vjetor financiar të këtij Këshilli. Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kemi ftuar kryetarin e KPMSHC-së, z. Arben Mehmeti dhe anëtarët tjerë të Këshillit, nga të cilët kërkohet që ta bëjë një prezantim të shkurtër të raportit, sa më i shkurtër që të jetë, sepse ne i kemi marrë materialet dhe pastaj që të hapet diskutimi, që deputetët nëse kanë pyetje ose diskutime, ose sqarime shtesë.

Arben Mehmeti: Të nderuar anëtarë të Komisionit, deputetë të Kuvendit të Republikës, në pika të shkurtra jam munduar ta bëj një përmbledhje. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, si institucion i pavarur, gjatë vitit 2022-2023, ka vijuar veprimtari në ushtrimin e funksioneve themelore të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, e që janë shqyrtimi dhe vendosja e ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil dhe monitorimi i institucioneve të administratës publike. Gjatë vitit 2022, Këshilli ka pranuar 1250 ankesa, ku në to përfshihen mbi 2190 civilë dhe për kandidatë 53 ankesa, ku të përfshirë ishin mbi 2100 nëpunës civilë, përkatësisht kandidatë për pranim në shërbimin civil. Përveç ankesave të pranuar gjatë vitit 2022, kishin po ashtu edhe 241 ankesa nga viti 2021 dhe 198 ankesa të viteve paraprake të vendosura nga Gjykata për vendosje në këshill, gjithsej qenë 1692 ankesa në tërë vitet.

Këshilli, në vitin 2022, ka arritur që të shqyrtojë gjithsej 1331 ankesa, ose 50% më shumë se në vitin 2022, që do të thotë se për rreth 250 ditë pune, pesë anëtarë të Këshillit, të ndihmuar nga bashkëpunëtorë profesionalë. Përveç shqyrtimit të ankesave, kemi realizuar 26 vizita monitoruese të rregullta dhe 6 vizita monitoruese të jashtëzakonshme, nga të cilat vizita janë evidentuar shkelje dhe janë dhënë rekomandime të posaçme për zyrtarë përgjegjës të institucioneve. Në vitin 2023, Këshilli ka pranuar 1854 ankesa, ku në to përfshiheshin edhe 2000 nëpunës civilë, përkatësisht kandidatë për

pranim në shërbimin civil, përveç ankesave të pranuar gjatë vitit 2023, kishim po ashtu edhe 311 ankesa të bartura nga viti 2022 dhe 49 të viteve paraprake, të cilat Këshilli u obligua t'i shqyrtojë nga gjykatat themelore në Prishtinë, departamentet për çështje administrative, ngase gjatë periudhës, raportuesit kishin për shqyrtim gjithsej 1144 ankesa.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar, Këshilli në vitin 2023 ka arritur që t'i shqyrtojë gjithsej 1760 ankesa, ose 20.6% më shumë se vitin paraprak, rreth 250 ditë pune, i bie që anëtarët mesatarisht të zgjidhin nga 7 deri në 9 ankesa për çdo ditë pune. Përveç shqyrtimit të ankesave, kemi realizuar edhe 11 vizita monitoruese të rregullta dhe 2 vizita monitoruese të jashtëzakonshme, nga të cilat kanë dalë rekomandimet përkatëse për institucionet përgjegjëse, kështu besoj fuqishëm se gjatë periudhës raportuese me shumë përkushtim jemi angazhuar për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës publike, duke dëshmuar konsistencë në vendimmarrje të paanshme, profesionale dhe në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet,

Kryetari: Kohë pas kohe, mund të shoh ndonjë gjobë dhe më intereson nëse të gjitha janë paguar?

Arben Mehmeti: Po, se nuk janë të paraqitura në raport, po nëse u është konfirmuar zbatimi i vendimit pas ligjit të Këshillit, në zbatimin e vendimit të Këshillit nga institucionet, shkon me propozim për gjobitje nga kryetari i kolegjit për kryetarin e Këshillit dhe si propozim-gjobitje nuk hyn e arkëtueshme në Këshill. Nga Thesari i Kosovës i ndalen në të hyrat, në pagën e atij zyrtari, i cili bën shkeljen dhe nuk zbaton vendimin e Këshillit, i ndalet.

Kryetari: A ka vend ose është një mënyrë tjetër? Apo a ka ndonjë përmbledhje vjetore se sa mund të kenë qenë këtu? A mund t'i nxirrni kështu të dhënat në lidhje me këtë?

Arben Mehmeti: Po, në mënyrë tabelore me shkrim, patjetër do t'i përcjell me shkrim për 3 vitet e fundit, do të përcjell përshkrim me institucionin, kryesisht në bazë statistikave të përafërta. Vetëm për vitin e kaluar kemi rreth 91 vendime të zbatueshme, disa tjerë janë në proces të zbatimit. Në mënyrë konkrete, për secilën vendim, do t'ju do t'ju raportoj me shkrim.

Nuk hedhet në votim, për shkak se nuk ka kuorum.

10. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2025-2027

Kjo pikë shtyhet për një mbledhje tjetër.

11. Të ndryshme

Kryetari pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë ndonjë çështje për të ngritur në këtë pikë. Meqë nuk pati, e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.

**Armend Muja,
Kryetar i Komisionit**
